



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD

Numri i lëndës: 2023:206200

Datë: 29.05.2024

Numri i dokumentit: 05749840

CN.nr.19/2023

GJYKATA THEMELORENË GJILAN – DEGA NË NOVOBËRDE, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Gazmend Ajvazi, me bashkëpunëtoresh profesionale Shkurte Kadriu, në procedurën jo kontestimore të propozueses D...I... nga fshati T..., Komuna e N..., të cilën me autorizim e përfaqëson Fadil Sinanaj avokat nga Gjilani, lidhur me shpalljen e personit të vdekur M... S..., pas mbajtjes së seancës dëgjimore, me datë 24.05.2024, ndërsa me datë 29.05.2024 përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesa e propozueses D... I. nga fshati T..., Komuna e N....

II. KONSTATOHET se **M... S...** me emër të babait S..., ka lindur më datë 04.08.1912, në fshatin Z..., ndërsa ka vdekur me datë 02.10.1994 në fshatin T..., Komuna e N.....

III. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, i njëjti do t'i dorëzohet, Zyrës së Gjendjes Civile në Novobërdë, për të bërë regjistrimin e faktit të vdekjes në librin amzë të të vdekurve.

A r s y e t i m

Propozuesja Dragutka Ivanoviq, më datë 22.09.2023, në këtë gjykatë ka paraqitur kërkesë për shpalljen e personit të vdekur për nënën e saj M...S...

Përfaqësuesi i propozueses av. Fadil Sinanaj, në propozimin për shpalljen e personit të vdekur si dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalë përfundimtare, ka deklaruar që e njëjta ka interes juridik që të vërtetohet se nëna e saj e ndjera M... S... ka vdekur, pasi që e ndjera ka në emër të saj të evidentuara ngastra kadastrale të evidentuara me nr. të lëndës 1468/2023 të datës 14.08.2023, andaj pasi që e njëjta është në fazën e shqyrtimit të trashëgimisë, dhe se pa regjistrimin e faktit të vdekjes së nënës së saj nuk ka mundësi të përpilohet dëshminë e vdekjes së të ndjerës M.. S..., e cila ka lindur me datë 04.08.1912 dhe ka vdekur me datë 02.10.1994 në fshatin T..., Komuna e N..., në moshën 82 vjeçare, gjykatës i ka propozuar që e ndjera M... S... nga fshati T..., Komuna e N..., të shpallet e vdekur, me qëllim që të bëhet regjistrimi në librin amzë të të vdekurve dhe të fillojë shqyrtimi i trashëgimisë.

Pas shqyrtimit paraprak të propozimit, gjykata ka caktuar seancën e datës 24.05.2024, në të cilën seancë përfaqësuesi i propozueses ka mbetur pranë propozimit të dorëzuar pranë kësaj gjykate, për shpalljen e personit të vdekur për nënën e propozueses - të ndjerën M...S, pasi që i njëjti ka deklaruar që janë plotësuar kushtet ligjore që e ndjera M...S me emër të bababit

Stojko, e lindur me datë 04 gusht 1912 në Z..., ka ndërruar jetë me datë 02.10.1994 në fshatin T..., Komuna e N.... Andaj gjykatës i ka propozuar që të dëgjohen dëshmitaret D..C.. dhe Sinisha Stojkoviç, si dhe që të aprovoj në tërësi propozimin për shpalljen e M...S si e vdekur, dhe në shërbimin e ofiqarisë në Komunën e N.... të regjistrohet në librat Amë të të vdekurve.

Gjykata për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike në këtë çështje juriidke në procedurën e të provuarit i ka administruar këto prova: Ekstrakti nga regjistri qendror i gjendjes civile me nr. serik E-27289956 e datës 14.08.2023 lëshuar nga ZGJC-N....-Ll.....; Certifikata e pronësisë me nr.1468-23, e datës 14.08.2023; Dëgjimi i dëshmitares D... C.... dhe propozueses Dragutka Ivanoviç e dëgjuar në cilësi të palës.

Pasi që gjykata e bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç, mbështetur nga dispozitat e nenit 8 te LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, andaj edhe:

Propozimin e propozueses e aprovoi si të bazuar.

Nga ekstrakti nga regjistri qendror i gjendjes civile me nr. serik E-27289956 e datës 14.08.2023 lëshuar nga ZGJC-N...-Ll..., gjykata vërtetoi faktin se D... I.... ka lindur me datë 12.12.1940 në I...., nga babai S... S.... dhe nëna M...S.

Nga certifikata e pronësisë me nr. të lëndës 1468-23, e datës 14.08.2023, gjykata vërtetoi faktin se ngastrat kadastrale me nr. P-72403028-00889-0 në sipërfaqe prej 330m², 02166-0 në sipërfaqe prej 723m², 02167-0 në sipërfaqe prej 997m², 02168-0 në sipërfaqe prej 648m², 02242-0 në sipërfaqe prej 507m², 02687-0 në sipërfaqe prej 4716m², 02722-0 në sipërfaqe prej 843m², 02734-0 në sipërfaqe prej 2623m², 02805-0 në sipërfaqe prej 191m², 02808-0 në sipërfaqe prej 376m², 02809-0 në sipërfaqe prej 336m², 02823-0 në sipërfaqe prej 1984m², 03016-0 në sipërfaqe prej 545m², 03017-0 në sipërfaqe prej 2607m², të gjitha ZK N...., të cilat evidentohen në emër të M... (S...) S... nga I....

Nga dëgjimi i dëshmitares D.. C..., njëherit vajza e propozueses D... I., e dëgjuar në seancën e datës 24.05.2024, gjykata ka vërtetuar se e njëjta ka deklaruar që e ndjera M...S tani më nuk është në jetë, pasi që ka vdekur me datë 02.10.1994 në moshën 82 vjeçare në fshatin Tërniçevc, Komuna e N...., tek nëna ime, ku e njëjta ka deklaruar se aty edhe është varrosur dhe kanë pritur të pame si dhe i kanë ndërtuar përmendore. Po ashtu ka deklaruar se e ndjera M...S, ka edhe një vajzë tjetër, por e njëjta është e martuar në Serbi dhe jeton atje, si dhe ka deklaruar që nëna e saj këtu propozuesja është kujdesur për të ndjerën në 25 vitet e fundit të jetës së saj, gjithashtu ka deklaruar që e ndjera ka pasur edhe dy vëllezër të cilët tani më kanë vdekur, e të cilët kanë lënë edhe pas ardhësit e tyre.

Nga dëgjimi i propozueses D... I...., e dëgjuar në seancën e datës 24.05.2024, gjykata ka vërtetuar se e njëjta ka deklaruar që e ndjera M...S, kishte qenë nëna e saj e cila kishte vdekur me datë 02.10.1994 në moshën 82 vjeçare si dhe e njëjta kishte pasuri në emër të vetin, si dhe e ndjera kishte vdekur tek propozuesja, pasi që e njëjta ishte kujdesur për të që nga viti 1971 e deri në vdekje, ku sipas traditave fetare e kishin varrosur dhe i kishin ndërtuar përmendore me shpenzime të familjes së propozueses. E njëjta ka deklaruar se e kishin regjistruar datën e lindjes për të ndjerën M...S, por të njëjtat ishin djegur në zyrën e Komunës së N.... dhe kjo ishte arsyeja që tani nuk figuron në librat Amë të lindjes.

Bazuar në dispozitat e nenit 73 të Ligjit për Procedurën Jokontesitmore është paraparë “*Në qoftë se vdekja faktike e një personi nuk mund të provohet me anë të dokumentit të parashikuar*

me ligjin për librat amzë, çdo person që ka interes juridik të drejtpërdrejtë dhe organi i kujdestarisë mund t'i paraqesin propozim gjykatës që me aktvendim të konstatojë vdekjen të këtij personi”.

Në bazë të provave të administruara materiale dhe deklaratave të dëshmitarëve, gjykata erdhi në përfundim se propozuesja D...I..., ka interes të drejtpërdrejtë juridik të provohet fakti i vdekjes së nënës së saj M...S, kurse me provat e shtjelluara është vërtetuar vdekja e të ndjerës, andaj gjykata në tërësi e aprovoi propozimin si të bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, konform nenit 73 të LPKJ.

Gjykata Themelore në Gjilan –Dega në Novobërdë, Departamenti i Përgjithshëm
CN.nr.19/2023, më datë 29.05.2024

Gjyqtari,
Gazmend Ajvazi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet kësaj gjykate.